



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR I KOSOVËS SEKRETARIJAT SUDSKOG SAVETA KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL SECRETARIAT		
Nr.Br.No.	01	1031-63
DAT.DT.	04.04.2012	

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 2008/02

PËR

UNIFIKIMIN E TAKSAVE GJYQËSORE

I ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimet e KGJK-së :
KGJK.nr.20/2012, datë 09 mars 2012 dhe
KGJK.nr.37/2012, datë 23 mars 2012



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke u bazuar në nenin 108, pika 5, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1,27 të Ligjit (Nr.03/L-223) për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe me qëllim të unifikimit të taksave gjyqësore, në mbledhjen e mbajtur më 23.03.2012, miraton,

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 2008/02
PËR
UNIFIKIMIN E TAKSAVE GJYQËSORE

Neni 1
Qëllimi

- 1.1 Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen taksat gjyqësore (në tekstin e mëtejme:taksa) në procedurën pran gjykatave në Republikën e Kosovës, si dhe mënyra e pagesës së tyre.
- 1.2 Procedura pagesës së taksës dhe shuma e taksës për parashtresa janë të caktuara me tarifën e taksave në përputhje me nenin 10, të këtij udhëzimi.

Neni 2
Përkufizimet

- 2.1 “Gjykatë” ose “gjykata”do të thotë gjykatat për kundërvajtje, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje, gjykatat komunale, gjykatat e qarkut, Gjykata Ekonomike e Qarkut dhe Gjykata Supreme e Kosovës, (duke përfshirë Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës).
- 2.2 “Taksë” do të thotë çfarëdo takse e përmendur në nenin 10, lista e tarifave të gjykatave.
- 2.3 “Palë” do të thotë pala që dorëzon padinë, kundërpadinë, ankesën ose çfarëdo parashtrese që dorëzohet në gjykatë.

- 2.4 “Parashtresë”, do të thotë padi, kundërpadi, ankesë, kundërshtim, kërkesë, revizion, propozim për ekzekutim, propozim për shqyrtimin e trashëgimisë, propozim për caktimin e masës së përkohshme, etj.
- 2.5 „Vendim”, do të thotë aktgjykim dhe aktvendim i marrë nga gjykata kompetente.

Neni 3

Përcaktimi i taksave për kërkesat civile

- 3.1 Përcaktimi i taksave gjyqësore, që duhet paguar në kohën e dorëzimit të parashtesës, bëhet në bazë të vlerës së kontestit të parashtesës, gjegjësisht natyrës së parashtesës.
- 3.2 Pas dorëzimit të parashtesës, gjyqtari të cilit i është ndarë lënda, mund ta caktojë vlerën e parashtesës. Nëse gjyqtari i caktuar në një lëndë, e përcakton vlerën e parashtesës më të madhe sesa ajo në bazë të së cilës është llogaritur taksa, atëherë:
- a. taksa për dorëzimin e parashtesës duhet të llogaritet duke u bazuar në vlerën e parashtesës së përcaktuar nga gjyqtari të cilit iu ka caktuar lënda,
 - b. nëse taksa për dorëzimin e parashtesës, e llogaritur në bazë të nenit 3.2.a, është më e lartë se sa taksa e paguar për dorëzimin e asaj parashtrese, pala e cila e dorëzon parashtesën, do të urdhërohet nga gjykatësi, të cilit i është ndarë ajo lëndë, që të paguajë shumën shtesë, si taksë shtesë.
 - c. parashtruesit të parashtesës duhet t’i caktohet data deri kur ai duhet të paguajë taksën shtesë, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e lëshimit të urdhrorit në bazë të nenit 3.2.b dhe dërgimit të tij në adresën e fundit të njohur të parashtruesit të kërkesës, të cilën ai ia ka dhënë gjykatës.

Neni 4

Mënyra e pagesës së taksave

- 4.1 Taksat llogariten dhe paguhen në monedhën e aplikueshme në Kosovë në kohën e pagesës.
- 4.2 Taksat, të cilat nuk tejkalojnë shumën prej 5 eurosh, paguhen me para të gatshme në arkën e gjykatës.
- 4.3 Taksat, të cilat tejkalojnë shumën prej 5 eurosh, paguhen në cilëndo bankë komerciale të Kosovës.
- 4.4 Pala, pas pagesës së taksës, është e obliguar të prezantojë fletëpagesën, si dëshmi për pagesën e saj.
- 4.5 Paratë nga taksat gjyqësore, të paguara në para të gatshme, duhet të dorëzohen në llogaritë bankare.

- 4.6 Secila gjykatë duhet t'i dorëzojë raportet për të hyrat Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas udhëzimeve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- 4.7 Taksa e paguar në gjykatë do të depozitohet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 5

Bartja e kompetencës; tërheqja e parashtrës

- 5.1 Taksa e paguar për çështjen për të cilën gjykata është shpallur jo kompetente, vlen edhe për gjykatën e cila caktohet si kompetente.
- 5.2 Nëse taksa e paguar është më e ulët apo më e lartë se ajo e gjykatës së cilës i është dërguar çështja për kompetencë, pala mund të obligohet për të paguar diferencën (pjesën shtesë të taksës) ose kthimin e asaj difference të taksës, nëse është paguar më tepër.
- 5.3 Nëse taksat shtesë, të vlerësuara në bazë të nenit 5.2, nuk paguhen deri në datën e caktuar, gjykata do të nis procedurën në pajtim me nenet 6.4 deri 6.7 të këtij udhëzimi.
- 5.4 Pas pagesës së taksave të kërkuara sipas nenit 5.2, gjykata do ta bartë lëndën në gjykatën kompetente, së bashku me dëftesat për pagesën e taksave. Gjykata që e përcjell dhe ajo që e pranon lëndën, duhet të raportojë ashtu siç parashihet në pikën 4.6.
- 5.5 Nëse tërhiqet parashtrësja, pasi të jenë paguar taksat, personi që ka paguar taksat nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim e taksave tashmë të paguara gjykatës.

Neni 6

Mbledhja e taksave, efekti i mos pagesës

- 6.1 Taksa duhet të paguhet me rastin e dorëzimit të parashtrësës, përveç në rastet, kur është përcaktuar ndryshe me anë të këtij udhëzimi.
- 6.2 Nëse kërkohet taksë shtesë, me urdhër të gjykatësit të caktuar në lëndë, gjykatësi duhet të përcaktojë datën deri kur taksa shtesë duhet të paguhet.
- 6.3 Nëse gjykatësi, të cilit i është caktuar lënda, vlerëson se palës që duhet të paguajë taksën duhet t'i jepet kohë shtesë për ta paguar taksën, në pajtim me nenet 7.3 ose 7.4 të këtij udhëzimi, duhet t' i mundësohet një gjë e tillë. Pala duhet ta paguajë taksën në datën që e ka përcaktuar gjykatësi të cilit i është caktuar lënda. Nëse nuk paguhet taksa në kohën e paraparë, gjykata fillon zbatimin e procedurave të parapara me udhëzim.
- 6.4 Nëse nuk paguhet me kohë taksa për dorëzimin e parashtrësës, nga pala kërkohet pagesa e taksës shtesë, siç është përcaktuar në nenin 10.25 të këtij udhëzimi.
- 6.5 Nëse nuk paguhen taksat deri në datën e caktuar, gjykata do ta njoftojë personin që është dashur t' i paguajë taksat, se ka përcaktuar një datë përfundimtare deri kur duhet të paguhen të gjitha taksat e papaguara, duke përfshirë edhe taksat shtesë, sipas neneve 6.4 dhe 10.25. Nëse ato nuk paguhen deri në datën përfundimtare, gjykata do të hedh poshtë parashtrësën për të cilën nuk janë paguar taksat.

- 6.6 Nëse edhe pas njoftimit nuk paguhen taksat, sipas nenit 6.4 të këtij udhëzimi, gjykatësi të cilit i është ndarë lënda, duhet të hedh poshtë padinë për të cilën nuk janë paguar taksat e kërkuara. Nëse kërkesa hedhet poshtë, sipas këtij paragrafi, atëherë pala nuk ka të drejtë të kërkojë kompensimin e taksave tashmë të paguara gjykatës.
- 6.7 Nëse një person ka marrë shërbime nga gjykata, për të cilat nuk është paguar taksa, ose ka dorëzuar një parashtresë për të cilën nuk është paguar ende taksa dhe i është zgjatur afati për pagesën e taksave të papaguara në kohën e dorëzimit të parashtresës, gjykata mund të nis procedurën e ekzekutimit civil për të mbledhur taksat e nevojshme, si shtesë e çfarëdo zgjidhje që siguron ky udhëzim. Nuk do të paguhet ndonjë taksë nga gjykatat për nisjen e procedurës së ekzekutimit civil.

Neni 7

Lirimi nga pagesa e taksave

- 7.1 Në rastet e përcaktuara me këtë udhëzim, lirohet nga pagesa e taksës personi i cili parashtron kërkesa që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, përveç kërkesave në të holla, si dhe personi me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ekzistencës së tij, respektivisht të anëtarëve të familjes së tij apo të personave tjerë të cilët varen nga ai.
- 7.2 Përveç nëse dëshmitë janë ndryshe të paraqitura, gjykatësi të cilit i është caktuar lënda duhet të konsiderojë se personi fizik nuk mund të paguajë taksën e përcaktuar në nenin 7.1, nëse:
- a. personi fizik siguron dëshmi se ai apo ajo është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose e agjencisë pasardhëse; ose
 - b. nëse personi siguron dëshmi se ai ose ajo është duke marrë ndihmë ligjore nga Zyra e Qarkut për Ndihmës Ligjore.
- 7.3 Gjykatësi mund të kërkojë nga personi, i cili më herët është konsideruar se i plotëson kushtet për lirim nga pagesa, që të paguajë më vonë taksën, nëse përmirësohet gjendja e tij financiare
- 7.4 Nga gjykatësi , të cilit iu ka caktuar lënda, mund t'i jepet kohë shtesë për të paguar shumën e tërësishme ose një pjesë të saj personit që ka kërkuar zgjatjen e afatit të pagesës, nëse kryesuesi i trupit gjykues përcakton:
- a. se ai person nuk kualifikohet për lirim nga pagesa e taksave sipas nenit 7.1, dhe
 - b. se zgjatja e afatit për të paguar shumën e tërësishme ose një pjesë të taksave është e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të individit.
- 7.5 Të gjitha parashtresat e paraqitura nga palët përkitazi më çështjet e cekura në këtë paragraf lirohen nga pagesa e taksës gjyqësore. Parashtresat e liruara nga pagesa e taksës gjyqësore janë:

- Korrigjimi, precizimi përkatësisht rregullimi i padisë;
- Dërgimi i adresës së saktë;
- Kërkesa për urgjencë për shkak të mospërfundimit të lëndës me kohë;
- Kërkesa për vazhdimin e procedurës së ndërprerë;
- Kërkesa për caktimin apo ndërrimin e avokatit;
- Parashtrësia me emrat e dëshmitarëve apo të ekspertit;
- Parashtrësia për heqje dorë nga kërkesëpapia;
- Parashtrësia për përfshirjen e trashëgimtarëve të njërës palë.

Neni 8

Publikimi i informatave në lidhje me taksat

- 8.1 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, të gjitha gjykatat e Kosovës, do t'i pajisë me nga një kopje të fundit të këtij udhëzimi , si dhe me ndryshimet tjera që mund të bëhen.
- 8.2 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës do t'ia dërgojë kopjet e këtij udhëzimi dhe ndryshimet e mundshme Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës, Shoqatës së Avokatëve të Kosovës, si dhe do t'i publikojë kopjet e këtij udhëzimi.
- 8.3 Në secilën gjykatë, duhet të publikohen një ose më shumë lajmërimet në lidhje me këtë udhëzim. Listën e taksave duhet vendosur në vendet më të dukshme, në lokacionet ku lajmërimet mund të shihen më së miri nga personat që hyjnë në ndërtesën e gjykatës dhe nga ata që kryejnë punë në lokacionet për pagesën e taksave, dorëzojnë dokumente, si dhe kërkojnë informata.
- 8.4 Gjykata duhet të ketë në dispozicion kopje të mjaftueshme të këtij udhëzimi, si dhe të listës së taksave për palët e interesuara..
- 8.5 Ky udhëzim dhe lista e taksave do të publikohen në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- 8.6 Lajmërimet në lidhje me këtë udhëzim dhe lista e taksave do të shpallen në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës.

Neni 9

Llogaritja e taksave për lëndët penale

- 9.1 Për procedurën penale të iniciuar nga prokurori publik sipas detyrës zyrtare dhe nga paditësi subsidiar, sipas nenit 62 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, nuk paguhet taksa.
- 9.2 Kur pala e dëmtuar dorëzon padi private, sipas nenit 54 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, taksat paguhet në përputhje me nenin 10.

Neni 10
Tarifat e taksave gjyqësore

	<i>Artikulli</i>	<i>Vlera e kërkesës</i>	<i>Taksa</i>
<i>Procedurat civile (kontestimore dhe jokontestimore)</i>			
10.1	Të gjitha parashtrirat për të cilat është e matshme vlera, përfshirë çfarëdo rasti të ndërlidhur me borxhet monetare, pronën e luajtshme apo të paluajtshme, dëmtimet, kontratat me vlerë monetare, trashëgiminë dhe ekzekutimin civil të borxheve.	Gjykata kompetente kur kërkesa është: 0 deri në 1.000 Euro 1.001 deri në 2.500 Euro 2.501 deri në 5.000 Euro 5.001 deri në 10.000 Euro Mbi 10.001 Euro	15 Euro 20 Euro 25 Euro 50 Euro 50 Euro + 0.5% deri në maksimumin prej 500 Euro
10.2	<u>Përveç kësaj</u> : Të gjitha parashtrirat që kanë të bëjë me ndarje fizike, rregullim mezhdash dhe sigurim provash.	Gjykata kompetente: a) Propozimet b) Ankesat	20 Euro 30 Euro
10.3	Dorëzimi i padisë për pengim posedimi	Gjykata kompetente	40 Euro
10.4	Dorëzimi i padive për zgjidhjen e martesës, përkujdesën e fëmijëve dhe për alimentacion	Gjykata kompetente	40 Euro
10.5	Dorëzimi i parashtrirave për çështje statusore, përfshirë: shpalljen e personit të vdekur dhe të zhdukur, vërtetimin e atësisë dhe të amësisë, marrjen e zotësisë së veprimit, marrjen e së drejtës prindërore, dhënien e pëlqimit për lidhjen e martesës, njohjen e aktgjykimit të huaj, adoptimet, etj.	Gjykata kompetente	15 Euro
10.6	Dorëzimi i parashtrirave për pronësi intelektuale duke përfshirë të drejtën e autorit dhe patentën.	Gjykata kompetente	40 Euro
10.7	Kërkesa për ndërhyrje në procedurë.	Gjykata kompetente	20 Euro
10.8	Të gjitha parashtrirat tjera	Gjykata kompetente	20 Euro
<i>Procedura në konfliktet administrative</i>			

10.9	Për paditë kundër aktit administrativ, kur vlera e kontestit është e matshme	0 deri në 1.000 Euro 1.001 deri në 2.500 Euro 2.501 deri në 5.000 Euro 5.001 deri në 10.000 Euro Mbi 10.000 Euro	20 Euro 25 Euro 30 Euro 60 Euro 100 + 0.5 % deri ne maksimumin prej 800 Euro
10.10	Për padi kundër aktit administrativ, kur vlera e objektit nuk është e matshme	Gjykata Supreme	40 Euro
10.11	Për ankesat kundër vendimit të shkallës së parë, për propozimin për përsëritjen e procedurës, për kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm dhe për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të vendimit		30 Euro
<i>Dhënia e vendimeve</i>			
10.12	Për aktgjykimet e shkallës së parë sipas vlerës së objektit		paguhet taksa sipas numrit tarifor 10.1.
10.13	Për aktvendimet sipas padisë për pengim posedimi		paguhet taksa sipas nr. tarifor 10.3.
10.14	Për aktgjykimet të cilat merren gjatë fazës të shqyrtimit paraprak të padisë dhe gjatë seancës përgatitore		paguhet taksa sipas numrit tarifor 10.1.
10.15	Për aktvendimet për hedhjen e padisë		paguhet gjysma e taksës, sipas numrit tarifor 10.1, por jo më shumë se 30 Euro
10.16	Për aktvendimin për dhënien e urdhërpagesës		paguhet gjysma e taksës sipas nr. tarifor 10.12, por jo më shumë se 30 Euro .
10.17	a) Për dhënien e aktvendimit		a) paguhet

	për masën e sigurisë, për aktvendim të përbarimit ose të urdhëresës së përkohshme. b) Nëse ky aktvendim nxirret në bazë të dokumenteve të huaja		gjysma e taksës sipas tarifës nr. 10.12, b) paguhet taksa e plotë sipas nr. tarifor 10.12.
10.18	Për aktvendimi më të cilin miratohet ose refuzohet propozimi për kthim në gjendje të mëparshme		paguhet gjysma e taksës sipas numrit tarifor 10.1, por jo më shumë se 25 Euro
10.19	Për aktvendim sipas propozimit për pranimin e vendimit të gjykatës së jashtme në kontestin statusor.		paguhet taksa në shumë prej 35 Euro
10.20	Për aktvendim të shpenzimet të procedurës, kur për to vendoset veç e veç		paguhet taksa sipas numrit tarifor 10.12.
10.21	Për vendim të gjykatës shkallës së dytë, sipas ankesës kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, sipas nr. tarifor 10.12 deri 10.18.		paguhet taksa sipas nr. tarifor 10.12
10.22	Për aktgjykimet dhe për aktvendimet e gjykatës së shkallës së tretë, sipas ankesës në aktgjykime apo aktvendime të gjykatave të shkallës së dytë		paguhet taksa dy fish nga numri tarifor 10.12
10.23	Për aktgjykimet e shkallës së parë dhe për aktvendimet e shkallës së dytë në konfliktet administrative.		paguhet taksa sipas nr. tarifor 10.9, përkatësisht 10.10
<i>Procedurat penale</i>			
10.24	Padi private dhe kundërpadi	Gjykata kompetente	40 Euro
10.25	Përpilimi i aktgjykimit për padi private	Gjykata kompetente	10 Euro
10.26	Ankesat, kërkesat për mbrojtjen	Gjykata kompetente	20 Euro

	e ligjshmërisë, kërkesat për përsëritjen e procedurës penale, kërkesat për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe kthimi në gjendjen e mëparshme		
<i>Shërbimet për vërtetimin e dokumenteve</i>			
10.27	Vërtetimi i dokumenteve për përdorim në botën e jashtme, “apostili”	Gjykata kompetente	5 Euro
10.28	Vërtetimi i garancioneve	Gjykata kompetente	10 Euro
10.29	Legalizimi i kontratave për shkëputjen e bashkësisë familjare, i autorizimeve dhe i deklaratave	Gjykata kompetente	5 Euro
10.30	Legalizimi i kontratave që kanë vlerë të matshme, siç janë ato për shitblerjen e paluajtshmërisë, kontratat për huan bankare, etj.	Gjykata kompetente Për vlerën e kontratës: 0 deri në 1.000 Euro 1.001 deri në 2.500 Euro 2.501 deri në 5.000 Euro 5.001 deri në 10.000 Euro 10.001 Euro e më shumë	10 Euro 15 Euro 20 Euro 25 Euro 25 Euro + 0.25 % deri në maksimumin prej 1000 Euro
10.31	Legalizimi i kontratave me vlerë të papërcaktuar	Gjykata kompetente	5 Euro
10.32	Lëshimi i certifikatave të ndryshme	Gjykata kompetente	5 Euro
<i>Shërbimet tjera</i>			
10.33	Fotokopjimi i dokumenteve gjyqësore dhe i librave publikë të mbajtura nga gjykata	Gjykata kompetente	50 cent për faqe
10.34	Ruajtja në depozitim gjyqësor	Gjykata kompetente Me vlerë të matshme	20 Euro+ 1% të vlerës për çdo vit pasues 20 Euro
10.35	Përpilimi i testamentit	Gjykata kompetente	25 Euro
10.36	Ndryshimi i testamentit	Gjykata kompetente	15 Euro
10.37	Ruajtja e testamentit	Gjykata kompetente	20 Euro
10.38	Lëshimi i certifikatave se nuk janë nën hetime	Gjykata kompetente	3 Euro
10.39	Shikimi i dosjeve të rasteve të përfunduara <i>Shënim: Nuk pagajné taksa personat që kanë caktuar avokat sipas detyrës zyrtare, dhe ata që janë nën</i>	Dosjet e mbyllura pas vitit 2000 Dosjet e mbyllura deri në vitin 2000	15 Euro 25 Euro

	<i>pakujdesje sociale.</i>		
<i>Taksat shitesë</i>			
10.40	Për vonesë të pagesës së taksave të kërkuara	Gjykata kompetente	10 Euro
10.41	Për bartjen e lëndës në gjykatë tjetër	Gjykata kompetente	10 Euro
10.42	Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës	Gjykata kompetente	20 Euro

Neni 11
Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohen të gjitha vendimet e gjykatave që kanë rregulluar këtë çështje.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe nënshkrimit të tij.


 Enver Peci
 Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës